



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2019:263370
Datë: 29.11.2019
Numri i dokumentit: 00683278

A.nr.1035/17

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, Departamenti për Çështje Administrative, Divizioni Fiskal, me gjyqtarin Rexhep Gashi dhe pjesëmarrjen e zyrtares ligjore [“A.F”], procesmbajtëse, në konfliktin administrativ të paditësit [“A...”] me seli në Prishtinë rr., të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Shoqëria e Avokatëve [“S...”] nga Prishtina, rr....., kundër të paditurës Dogana e Kosovës në Prishtinë, duke vendosur lidhur me padinë e paditësit për anulimin e Aktvendimit me nr.06.2/198, 230 të datës 25.05.2017, jashtë seance, me datë 29.11.2019, mori këtë:

A K T V E N D I M

KONSIDEROHET SE ËSHTË TERHEQUR ankesa-padia me numër A.nr.1035/17 e paditësit [“A...”] me seli në Prishtinë rr., për shkak të mos pagesës së taksës gjyqësore.

A r s y e t i m

Paditësi [“A...”] me seli në Prishtinë rr....., përmes të autorizuarit ka parashtruar ankesë-padi në këtë gjykatë me datë 21.06.2017, kundër të paditurës Dogana e Kosovës në Prishtinë, për anulimin e Aktvendimit nr.06.2/198, 230 të datës 25.05.2017.

Gjykata me rastin e përgatitjes së shqyrtimit kryesor të çështjes, pas shqyrtimit paraprak të padisë, ka gjetur se paditësi nuk ka paguar taksën gjyqësore për padi.

Gjykata me dt.14.10.2019, të autorizuarit të paditësit i’ a ka dërguar vërejtjen për pagimin e taksës gjyqësore për padi në shumën prej 50€ (pesëdhjetë euro), në afatin prej 15 ditësh nga dita e pranimit, me paralajmërimin se nëse nuk paguhet taksa gjyqësore sipas afatit të caktuar dhe nuk ekzistojnë kushtet për lirim nga taksa gjyqësore atëherë gjykata do të merr vendimin me të cilin padia e paditësit do të konsiderohet e tërhequr. Nga fletë dërgesa për dorëzim personal shihet se i autorizuari i paditësit e ka pranuar vërejtjen për pagesën e taksës për padi me datë 16.10.2019, por përkundër kësaj nuk ka vepruar sipas vërejtjes për pagesën e taksës gjyqësore, pra nuk e ka paguar taksën, siç është parashikuar me Udhëzimin Administrativ Nr.01/2017 për Unifikimin e Taksave Gjyqësore të Këshillit Gjyqësor të Kosovës.

Meqenëse paditësi nuk e ka paguar taksën gjyqësore për padi dhe në rastin konkret nuk ekzistojnë konditat për lirim nga pagimi i taksave gjyqësore, gjykata duke u bazuar në nenin 63 të LKA-së dhe nenin 253.5 të LPK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Nga të lartcekurat, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
Departamenti për Çështje Administrative, Divizioni Fiskal
A.nr.1035/17, me dt.29.11.2019

Procesmbajtësja
[“A.F”]

G j y q t a r i
Rexhep Gashi

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh, nga dita e pranimit të aktvendimit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.